



Kolegji ESLG

KODI I MIRËSJELLJES PËR STUDENTË

Neni 1

Te drejtat

1.1 Të drejtat e studentëve janë si në vijim:

1. e drejta për arsimim universitar sipas dispozitave ligjore në fuqi,
2. e drejta t'i shfrytezoj të gjitha format dhe mjetet të cilat i posedon BpRAL-ja siç janë sallat e mësimi, laboratorit, dhe mjetet tjera të cilat ndikojnë në zhvillimin e veprimtarisë edukative arsimore të studentit;
3. të degjoj dhe të jete i degjuar;
4. t'i shpreh mendimet dhe idetë e tij;
5. të jete i informuar se çka pritët prej tij;

Neni 2

Obligimet e studentit

2.1 Për të krijuar atmosferë pune për zhvillim të procesit mësimor përcaktohen këto obligime:

1. të vijoj mësimin sipas orarit të përcaktuar nga universiteti
2. të respektojë Kodin e mirësjelljes së universitetit;
3. të respektojë integritetin e personalitetit të secilit anëtar të bashkësisë së Kolegjit
4. të jetë i përgatitur për mesim;



Kolegji ESLG

5. të ketë kujdes për higjienën dhe mjedisin;

6. të respektojnë rregullat, rregulloret dhe politikat e Kolegjit të nxjerra nga organi vendim-marrës i Kolegjit;

Neni 3

Sjellja e mirë

1.1 Komuniteti i Kolegjit përbëhet nga një mjedis divers i përbërë nga njerëz të profesioneve të ndryshme, përkatësisë së ndryshme sociale, kulturore, etnike, fetare dhe gjeografike. Sjellja e mirë nga stafi dhe studentët është me rëndësi për ruajtjen e mjedisit të shëndoshë dhe reputacionit të Kolegjit.

Neni 4

Keqsjellja

4.1 Keqsjellja i përket njëres nga kategoritë e paraqitura si në vijim:

1. sjellje që shkakton lëndim personal, ofendim apo shqetësim tek personi tjetër apo që shkakton dëmtim të pronës dhe rendit të Kolegjit brenda dhe jashtë godinës së Kolegjit;

2. sjellja e cila ndikon në të drejtat e studentëve të tjerë dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit të Kolegjit në gëzimin e të drejtës së tyre për mësim të qetë në godinën e Kolegjit. Sjellja e tillë përfshin shqetësimin apo shpërndarjen e materialeve të cilat mund të kërcënojnë apo abuzojnë personin tjetër në baza fetare, seksuale apo etnike;

4.2 Studentët nuk guxojnë të falsifikojnë apo keqpërdorin emrin, logon dhe diplomën e lëshuar nga universiteti;

4.3 Studentët nuk guxojnë të përfshihen në sjellje mashtruese dhe të pandershme në gjatë dhënies së provimit;

4.4 Studentët nuk guxojnë të përfshihen në kopjimin e pronës intelektuale të dikujt tjetër apo në plagjiaturë.



Kolegji ESLG

4.5 Studentët nuk guxojnë të vjedhin dhe keqpërdorin resurset e Kolegjit

4.6 Studentët nuk guxojnë të kenë qasje të paautorizuar në godinën e Kolegjit;

4.7 Studentët nuk guxojnë të përdorin substanca narkotike;

4.8 Studentët nuk guxojnë të përfshihen në vepra penale të cilat shkaktojnë diskreditim dhe dëmtim të interesave të Kolegjit;

Neni 5

Stafi i Kolegjit që merret me rastet e keqsjelljes

5.1 Drejtorat e programeve të studimit, regjistrari dhe drejtori i Kolegjit merren me rastet e keqsjelljes së studentëve në universitet.

Neni 6

Masat disiplinore

6.1 Në rast të keqsjelljes masat disiplinore si në vijim do të shqiptohen kundër studentit varësisht nga natyra e keqsjelljes:

1. vërejtje me gojë;
2. vërejtje me shkrim;
3. pezullim për një muaj nga procesi mësimor;
4. pezullim për një semestër nga procesi mësimor;
5. pezullim për një vit akademik nga procesi mësimor;
6. përjashtim nga universiteti;

Neni 7

Hyrja në fuqi

7.1 Ky kod hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga Presidenti i Bordit Menaxhues.

Prof. Dr. Edmond Hajrizi, 20.08.2019



Nazim Gafurri 33 Prishtinë Republika e Kosovës
T: +383 38 602 405
T: +383 44 159 867
E: info@eukos.org
W: www.eukos.org

